



School of  
Management and Law

# Zbatimi i kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara: sfidat kryesore dhe mësimet e nxjerra




**Ngritje e zotësive. Kapërcim i kufijve.**

**Prof. Dr. Andreas Bergmann, Drejtor për Sektorin Publik**  
[andreas.bergmann@zhaw.ch](mailto:andreas.bergmann@zhaw.ch)

# Reformat e suksesshme të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara kërkojnë një model të gjithanshëm reforme



**Kapaciteti politik** është kapaciteti i qeverisë për të siguruar mbështetje politike si edhe për të siguruar burimet e nevojshme (financiare dhe jofinanciare) për t'u përdorur nga procesi i reformës ose për t'u investuar në të. Kapaciteti politik përfshin edhe një vizion dhe objektiv të qartë të reformës.



**Kapaciteti institucional / organizativ** është aftësia për të përcaktuar masat organizative, strukturat dhe proceset institucionale në mbështetje të reformës së parashikuar për kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik. Ky përfshin qeverisjen e duhur të reformës dhe monitorimin e procesit të reformës.



**Kapaciteti teknik** është aftësia për të ngritur infrastrukturën e duhur teknike dhe format e tjera të kapaciteteve (pra, TI, IFMIS, softuerë, hartimi dhe integrimi i planit kontabël etj.) në mbështetje të procesit të reformës.



**Kapaciteti njerëzor** është aftësia për të hartuar një program të qëndrueshëm për ngritjen e kapaciteteve njerëzore, për t'i përgatitur dhe aftësuar kështu njerëzit të kryejnë detyra të reja që lindin nga reforma e parashikuar.

# Modele të ndryshme të reformave të kontabilitetit

## Modeli i realizueshëm dhe i suksesshëm i transformimit


Progresi i reformës



Burimi: Banka Botërore, 2020

## Modeli i transformimit me probabilitet më të ulët suksesi

Progresi i reformës



# Vënia në zbatim e SNKSP-ve: sfidat kryesore dhe mësimet e nxjerra



**Zbatimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë** Me sukses janë ndjekur të dyja qasjet. Zbatimi i tërthortë ka përparësinë se çështjet marrin zgjidhje që herët në proces.

- **Kapaciteti politik dhe institucional:** Sqarohet herët.
- **Baza normative:** Lidhje e fortë me legjislacionin kombëtar. Hierarki e qartë normative, përfshirë kuadrin konceptual, standardet, politikat, planin kontabël, interpretimet dhe udhëzuesin.



**Projektet shumëvjeçare të vënies në zbatim zgjatin 5 deri 7 vjet:** Përgatitje rigoroze, me piketa kohore të përcaktuara qartë dhe të matshme, por pastaj periudha kalimtare është vetëm një vit (≠ SNKSP 33).



**Kapaciteti teknik:** Nuk ka një zgjidhje TI “të gatshme” dhe duhet hartuar një projekt, përfshirë edhe ndërfaqen me GFS-në.



Faleminderit!



[www.zhaw.ch/ivm](http://www.zhaw.ch/ivm)